

Data 30/04/2024

**PROCESVERBAL - TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “SHËRBIM IMPLEMENTIMI PËR SISTEMIN GIS NË KESH SH.A”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 98390000-3 -
Shërbime të tjera.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9,454,000 (Nëntë milion e katërqind e pesëdhjetë e katër mijë) Lekë
pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor KESH sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Nr.3;

b. Formulari përmbledhës i vetë deklarimit, sipas shtojcës Nr.9;

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): Kjo kërkesë përmbushet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklarimit sipas shtojcës Nr.9.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit të përlogaritur të kontratës.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në llojin e procedurës së prokurimit e cila është: “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, argumentohet si më poshtë:

- Përcaktimi i vlerës së kërkuar është një kërkesë e mbështetur në pikën 4 të nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) *Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

b) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 55, pika 4/b të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri vërtetohet se operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për Autoritetin Kontraktor KESH sh.a, plotësimi i këtij kriteri është i rëndësishëm pasi shërbimet e mëparshme të ngjashme të realizuara në sektorin publik apo sektorin privat janë kushte të nevojshme që garantojnë se Operatorët Ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të mëparshme të ngjashme vërtetojnë se zotërojnë kapacitete për të zbatuar me sukses këtë procedurë prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ISO ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 27001:2022 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”;
- c) ISO/IEC 20000-1:2018 “Sistemi i menaxhimit të shërbimit”;

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Janë kërkuar këto certifikata, që të vërtetojë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standardeve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Çertifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore.

ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse shërbimet e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 27001:2022 “Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit”– Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë të informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike. Duke qenë se AK KESH është pjesë e infrastrukturës kritike, siguria e informacionit është thelbësore.

ISO/IEC 20000-1:2018 “Sistemi i menaxhimit të shërbimit” - Ky standard është i nevojshëm për të specifikuar kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të shërbimit. Ky sistem mbështet menaxhimin e ciklit jetësor të shërbimit, duke përfshirë planifikimin, projektimin, tranzicionin, shpërndarjen dhe përmirësimin e shërbimeve, të cilat përbushin kërkesat e dakorduara dhe japin vlerë për konsumatorët, përdoruesit dhe organizatën që ofron shërbime. Ky standard u jep kompanive mundësinë të demonstrojnë aftësitë profesionale të tyre në zbatimin e projekteve të teknologjisë së informacionit.

Sa më sipër janë kërkuar certifikata që të vërtetojnë se ofertuesit kanë sisteme menaxhimi sipas standarteve ndërkombëtare të cilat reflektojnë dukshëm edhe në cilësinë e shërbimit. Kërkesat janë të mjaftueshme për të siguruar ofertues me kapacitete teknike cilësore të certifikuar edhe me certifikata menaxhimi të cilësisë të njohura ndërkombëtare. Certifikatat e kërkuara për OE janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore. Certifikatat e kërkuara janë vendosur në përputhje me specifikimet teknike si dhe u arsyetuan të nevojshme për të siguruar ofertues serioze.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, për periudhën Shkurt 2024 – Mars 2024, një minimum punonjësish të certifikuar për:

- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për software GIS Server,
- ✚ Jo më pak se 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi ose autoritete/institucione/ente të autorizuar për software GIS Desktop;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Certifikatat e mësipërme të vlefshme,
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Shkurt 2024 – Mars 2024.

Shënim: Pranoen rastet kur një punonjës disponon më shumë se një certifikatë.

Argumentimi:

Kërkesat për punonjësit, janë kërkuar në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku me anë të këtij kriteri vërtetohet që operatorët ekonomikë dëshmojnë se kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit. KESH sh.a, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një staf të kualifikuar.

Në lidhje me punonjësit, argumentojmë si më poshtë :

-Është kërkuar jo më pak se 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi ose autoritete/institucione/ente të autorizuara për software GIS Server, pasi ky shërbim (i kërkuar) përfshin mirëmbajtjen e software-it GIS për server. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë që ka kapacitetet e nevojshme për të operuar plotësisht softin për server.

-Është kërkuar jo më pak se 1 (një) punonjës i certifikuar nga prodhuesi ose autoritete/institucione/ente të autorizuara për software GIS Desktop, pasi ky shërbim përfshin mirëmbajtjen e software GIS Desktop. Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë që ka kapacitetet e nevojshme për të operuar plotësisht softin për Desktop.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose distributori i autorizuar ku të vërtetohet lidhja me prodhuesin, për shërbimet objekt prokurimi.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa në lidhje autorizimin e prodhuesit ose distributorit të autorizuar është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve garantojnë AK-në se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të shërbimeve të kërkuara në cilësinë dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike. Këto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Në ditët e sotme, ndërmarrjet utilitare duhet të jenë në gjendje të maksimizojë buxhetet dhe të koordinojnë aktivitetet për të ulur koston, përpjekjet e ekipeve të mirëmbajtjes dhe kohën që nevojitet për realizimin e proceseve të inspektimit dhe mirëmbajtjes. Megjithëse mund të ketë një sërë mënyrash për të arritur këtë, Sistemet e Informacionit Gjeografik (GIS) janë një nga më efektivet.

Gjatë zhvillimit të projekteve inxhinierike madhore, vihen në dispozicion informacione ekzistuese ose prodhohen informacione të formateve të ndryshme të cilat referojnë informacion për asetet në terren.

KESH për nevoja të korporatës do të duhet të koordinojë punën e inxhinierëve në zyrat qendrore me inxhinierët në terren, të realizojë analiza të ndryshme hapësinore si dhe të prodhojë harta të nevojshme në format digjital (WEB) ose letër (PDF, JPG).

Për të realizuar me sukses detyrat funksionale si dhe për të pasur informacion gjeografik të përditësuar mbi asetet, nevojitet një sistem i integruar për inventarizimin, standardizimin, analizimin dhe menaxhimin e këtyre asetëve si dhe të inxhinierëve.

Njësia e Prokurimit